



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:041502
Datë: 25.06.2021
Numri i dokumentit: 01924655

PPP.nr.08/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit Kompania e Sigurimeve I. SH.A me seli në Bulevardi “.....” nr. .. P., kundër debitorit M. V. me adresë në fsh. Ll. i B. Komuna e Istogut, për shkak të borxhit në shumë prej 132.96 €, pas prapësimit të ushtruar nga ana e debitorit, me dt: 23.02.2021 kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, gjykata jashtë seance me dt.25.06.2021 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET prapësimi i debitorit M. V. me adresë në fsh. Ll. i B. Komuna e Istogut, ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.59/2021 të dt. 12.02.2021, dhe **SHFUQIZOHET** urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.59/2021 të dt. 12.02.2021, dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore abrogohen.

A r s y e t i m

Kreditori, Kompania e Sigurimeve I. SH.A me seli në Bulevardi “.....” nr. 33 P., ka ushtruar propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm faturës, ndaj debitorit M. V. me adresë në fsh. Ll. i B. Komuna e Istogut, duke kërkuar që të lejohet përmbarimi dhe të obligohet debitorit pagesën e borxhit në shumë prej 132.96 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore të gjitha në afat 7 ditor nga dita e pranimit të propozimit, në të kundërtën ti bllokoj të gjitha llogarit bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjetet monetare në llogari të bëhet sekuestrimi, regjistrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të pa

luajtshme dhe mjetet e mbledhura të barten në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbarim të datës 12.02.2021.

Përmbaruesi privat, me urdhrin P.nr.59/2021 të dt. 12.02.2021, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit në këtë çështje përmbarimore.

Debitori, M. V. me adresë në fsh. Ll. i B. Komuna e Istogut brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim kundër urdhrin përmbarimor, duke i propozuar gjykatës që propozimin për përmbarim ta refuzoj si të pa bazuar dhe të lirohet nga obligimi material i cili përshkruhet në propozim me arsyetimin se në tersi ju kam përmbajtur kontratës dhe e kam përmbushur obligimin, ku i propozoj gjykatës që të caktoj seancë dhe pas administrimit të provave të anuloj propozimin për përmbarim tërësisht të pa bazë.

Pas ngritjes së prapësimit nga ana e debitorit, me të njëjtin është njoftuar kreditori si he me mundshin ushtrimin të përgjigjes në prapësim, mirëpo në shkresë të lëndës nuk ka dëshmi që ka parashtruar përgjigje.

Gjykata Themelore në Pejë- Dega Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP-së, vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i bazuar. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata zyrtarisht, pas shqyrtimit të provave në shkresat e lëndës, konstaton faktin se është e obliguar zyrtarisht që të shikoj se lejimi i përmbarimit a është bërë konform dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore si dhe dokumenti që shërben si bazë për lejimin e përmbarimit a i plotëson kushtet ligjore, e në rastin konkret erdhi në përfundim se dokumentet që kanë shërbyer si bazë për lejimin e përmbarimit- faturat nuk i plotësojnë kushtet ligjore dhe janë të pa përshtatshme për përmbarim sepse të njëjtët nuk janë të pranuar e as të nënshkruara nga ana e debitorit, andaj duke u bazuar në dispozitat e nenit 71 par.1.1 të LPP-së i cili nën parashihet se një ndër shkaqet e prapësimit është edhe ajo se “Dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmerisë”, andaj e aprovoj prapësimin e debitorit dhe rrjedhimisht e shfuqizoj urdhrin përmbarimor dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore i abrojoj.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, konform dispozitave të nenit 3, 21, 29 par.1.3 dhe par.3, 38, 69, 71 par.1,1 dhe 73 par. 3, të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG

PPP.nr.08/2021, dt.25.06.2021

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në P., e përmes kësaj gjykate.